

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Presidenti Bajram Begaj mori pjesë në 245-vjetorin e themelimit të Teqesë së Frashërit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/presidenti-bajram-begaj-mori-pjese-ne-245-vjetorin-e-themelimit-te-teqes-i584213
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 07:13:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 13:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ce91b54c9564bd696b900db9312981c69f486309e4e89f91c33074b2119636b3
TEKSTI	a60ddbc7d9f1c29268aaec649aa63546feb6810a6b14bfcf9b73656b32fed5e
PAMJA	155d2120f4a3a55e2ca32d9951bba4db3b84f22ef1c9e50c1b3be0a521c52a98

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3840415e6003ce42ddeabc64112ea5b644ceee49f9f9049a002f743b94673e2d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	06228d72b62d721da89ad9d8f88b641ef39e753d7557342e2aba3a1beafa7f90
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmaU9TuouoiwTpN4nNecxQMcyu59TjNs8nteVzFNNQZ8Qt



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3840415e6003ce42ddeabc64112ea5b644ceee49f9f9049a002f743b94673e2d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e Festivali Kombëtar i Filmit shqiptar bashkon kineastet dhe publikun Nga informatika tek inteligjenca artificiale. Pse kam te drejte te jem dyshues? Jarr ne hyrje te Syrit te fundit

Presidenti Bajram Begaj mori pjesë në 245-vjetorin e themelimit të Teqesë së Frashërit



6 Shtator 2026, 15:10 Kulturë TEMA



Presidenti Bajram Begaj mori pjesë dje në 245-vjetorin e themelimit të Teqesë së Frashërit.

Para besimtarëve bektashinj, të cilët 5 shtatorin e kanë ditë pelegrinazhi, Presidenti Begaj nderoi vëllezërit Frashëri dhe kujtoi vlerat historike të kësaj teqeje për përhapjen e dijes, për ruajtjen e identitetit shqiptar dhe çështjen kombëtare.

“Që nga viti 1781, kur ‘hodhi çatinë’ kjo teqe, ajo nuk shërbeu vetëm si vend lutjeje. Ajo u bë shtëpi e hapur për udhëtarin, vatër dijeje e kuvendimi dhe, mbi të gjitha, vatër e ndërgjegjes shqiptare”, deklaroi Presidenti në fjalën përshëndetëse.

Kreu i Shtetit kujtoi rolin e klerikëve bektashinj në momentet vendimtare për shqiptarët, nga Rilindja, deri në ndërtimin e shtetit.

Duke u ndalur në filozofinë dhe frymën e besimit, Presidenti i Republikës theksoi kontributin e bektashinjve në bashkëjetesën fetare.

“Në ditët tona ne flasim shumë për harmoninë fetare, vërtet një vlerë e jashtëzakonshme, dhe shpesh rrezikojmë ta kthejmë atë në një formulë protokollare, por harmonia fetare shqiptare nuk lindi në tryeza zyrtare apo si çështje protokollare. Ajo u gatua në vende si kjo teqe, nga breza klerikësh e besimtarësh që ditën të ishin të përkushtuar në besimin e tyre dhe, njëkohësisht, të shihnin tek tjetri bashkëkombësin, fqinjin, vëllain e të një gjaku e të një gjuhe”, u shpreh Presidenti Begaj, duke theksuar se mesazhi i bektashizmit për urtësi, maturi e ndërtim urash mes njerëzve është sot po aq i gjallë dhe i nevojshëm sa dikur.

“Drita e besimit dhe kujtesa e një populli nuk mund të shlyhen”, u shpreh ai, duke kujtuar dhe përpjekjet e klerikëve që i mbijetuan diktaturës në Shqipëri dhe rizgjuan besimin.

Begaj theksoi rëndësinë për mbrojtjen dhe përcjelljen e kujtesës kombëtare dhe identitetit kombëtar.

Në fund të fjalës përshëndetëse, Presidenti i Republikës u shpreh se “pelegrinazhi në Frashër është një udhëtim në rrënjët e identitetit tonë, atje ku besimi u bë dije, dija u bë vetëdije dhe vetëdija u bë atdhetari”.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Shenjtërimi i Nënë Terezës - Begaj: Nënë Tereza ishte misionarja shqiptare e bamirësisë](#)

21:15 Kulturë / 5 komente

[Sot shenjtërimi i Nënë Terezës/ BE dhe SHBA: Trashëgimia e Nënë Terezës duhet të shërbejë si frymëzim për të gjithë](#)

20:05 Kulturë / 4 komente

Gjysmë dite në Gjenevë

17:08 Kulturë / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.